



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 398, datë 9.6.2022

PËR

**TRAJTIMIN E DISBALANCAVE TË SHKAKTUARA
NGA PRODHUESIT ME PËRPARËSI TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 99, të ligjit nr.43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. QËLLIMI I VENDIMIT

Ky vendim përcakton mënyrën e trajtimit të disbalancave të shkaktuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike dhe kostot përkatëse për mbulimin e tyre.

II. PËRKUFIZIMET

Në këtë vendim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “**Grupi i balancimit**”, një grup i përbërë prej dy ose më shumë palëve përgjegjëse balancuese në tregun e energjisë elektrike, që, për qëllim të balancimit, bashkojnë skedulet e tyre dhe matjet nga pikat matëse duke transferuar përgjegjësinë e tyre të balancimit te lideri i grupit të balancimit dhe duke vepruar si palë e vetme përgjegjëse balancuese për shlyerjen e disbalancave.
2. “**Lideri i grupit të balancimit**”, pala përgjegjëse balancuese, tek e cila pjesëmarrësit e tjerë të grupit balancues kanë transferuar përgjegjësinë e tyre të balancimit. Ai përfaqëson grupin në komunikim, skedulim dhe shlyerjen e disbalancave kundrejt OST, sh.a.-së, në përputhje me rregullat e balancimit në fuqi.
3. “**Pagesë për prodhimin e matur**”, pagesa, bazuar në vlerat e matura të energjisë së prodhuar.

4. **“Pagesë për prodhimin e nominuar”**, pagesa, bazuar në vlerat e nominuara të programit të prodhimit, në përputhje me rregullat e balancimit në fuqi.
5. **“Matje sipas intervaleve të caktuara kohore”**, sistem matjeje (tërësia e pajisjeve përbërëse të sistemit të matjes), i aftë të masë, të regjistrojë dhe të transmetojë të dhënat në drejtim të një platforme elektronike në intervale të caktuara kohore, të integruar me sistemin e matjes së OST, sh.a.-së, dhe në përputhje me Kodin e Matjes.

III. PARIME TË PËRGJITHSHME

1. Në përputhje me nenin 22.5, të ligjit nr.7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, dhe rregullat e tregut të balancimit, të miratuara nga ERE, prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike janë përgjegjës për disbalancat dhe kostot përkatëse që ato shkaktojnë në sistem, në përputhje me rregullat e tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike, të miratuara nga ERE.
2. Prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, të cilët kanë një kontratë shitblerjeje energjie elektrike me shoqërinë e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për blerjen e energjisë nga burimet e rinovueshme, nga data 1 prill 2021 janë automatikisht pjesë e Grupit të Balancimit të Operatorit të Energjisë së Rinovueshme (OER).
3. Prodhuesit e parashikuar në pikën 2, të këtij neni, të pajisur me të dhëna matjeje sipas intervaleve të caktuara kohore, mund të vendosin për përgjegjësinë e tyre për balancimin, duke zgjedhur një prej opsioneve të mëposhtme:
 - a) Nënshkrimin e një kontrate direkt me OST, sh.a.-në, në përputhje me rregullat e balancimit në fuqi.
 - b) Transferimin e përgjegjësisë së tyre balancuese te një grup tjetër balancues, i ndryshëm nga grupi i balancimit OER.
4. Për prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, të cilët për përgjegjësinë e tyre të balancimit kanë zgjedhur opsionet sipas pikës 3, të këtij kreu, kontrata tip e shitblerjes së energjisë elektrike, e miratuar nga Enti Rregullator i Energjisë, ndryshon nga pagesa për prodhimin e matur në pagesë për prodhimin e nominuar.

IV. OER, LIDER I GRUPIT TË BALANCIMIT

1. Në rolin e tij si lider i grupit të balancimit, OER-ja do të alokojë te prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike vlerën neto të faturave mujore të disbalancave në përpjesëtim me prodhimin e matur të energjisë.

- Në rast se grupi i balancimit ka në përbërje dhe palë të tjera përgjegjëse balancuese, të ndryshme nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, atëherë lideri i grupit të balancimit do të alokojë te të gjithë pjesëmarrësit e grupit vlerën neto të faturave mujore të disbalancave, sipas formulës së mëposhtme:

$$VFD (PPB)_{i=1..n} = FND_{LGB} * \frac{(Energji\ e\ matur)_{PPB_{i=1..n}}}{\sum_{i=1}^n (Energji\ e\ matur)_{PPB_i}}$$

Ku:

VFD – vlera e faturës së disbalancave për palën përgjegjëse balancuese.

FND_{LGB} – fatura neto e disbalancave pozitive dhe negative për liderin e grupit të balancimit,

$(PPB)_{i=1..n}$ – palët përgjegjëse balancuese të grupit të balancimit

$(Energji\ e\ matur)[MWh]$ – sasia e energjisë totale e prodhuar dhe konsumuar (në vlerë absolute) nga të gjithë palët përgjegjëse balancuese të grupit të balancimit të Operatorit të Energjisë së Rinovueshme.

- OER-ja në të njëjtën mënyrë do të shpërndajë çdo kosto shtesë nga zbatimi i mekanizmit balancues.
- Përveç sa më sipër, për shërbimin e balancimit, lideri i grupit të balancimit, Operatori i Energjisë së Rinovueshme do t'i ngarkojë pjesëmarrësve të grupit të balancimit një tarifë për mbulimin e shpenzimeve të këtij shërbimi, e cila përfaqëson kostot e OER-së për njësi lekë/kwh, shumëzuar me energjinë e matur/prodhuar.
- Pagesa për shërbimin e balancimit do të jetë shuma e vlerës së faturës së disbalancave për palën përgjegjëse balancuese plus tarifën e shërbimit të balancimit, sipas formulës së mëposhtme:

$$Pagesa\ totale = VFD (PPB)_i + tarifa$$

V. TË TJERA

- Prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike duhet të pajisen me sistem matjeje sipas intervaleve të caktuara kohore, brenda datës 30.9.2022.
- Me përfundimin e afatit të parashikuar në pikën 1, të këtij kreu, faturimi për energjinë elektrike të prodhuar nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike do të bëhet vetëm në përputhje me të dhënat e sistemit të matjes, sipas pikës 5, të kreut 2, të këtij vendimi.

VI. DISPOZITA KALIMTARE

1. Deri në fillimin e veprimtarisë funksionale të OER-së, ngarkohet “Furnizuesi i Tregut të Lirë”, sh.a., për kryerjen e detyrave të këtij operatori, të parashikuara në këtë vendim.
2. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendrike nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, në përputhje me pikën 2, të kreut 3, të këtij vendimi, “Furnizuesi i Tregut të Lirë”, sh.a., do t’i përcjellë OST, sh.a.-së, aneksin “Agregimi i grupit të balancimit”, sipas formatit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Subjektet, që janë shpallur fituese, sipas procedurave konkurruese të përcaktuara në vendimin nr.349, datë 12.6.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e masave mbështetëse për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit dhe erës, si dhe të procedurave për përzgjedhjen e projekteve për përfitimin e tyre”, negociojnë marrëveshjen e balancimit me blerësin e energjisë elektrike.
4. Ngarkohen prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, “Furnizuesi i Tregut të Lirë”, sh.a., Operatori i Sistemit të Transmetimit, sh.a., Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, sh.a., dhe Operatori i Energjisë së Rinovueshme, sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

VII. TË FUNDIT

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDIRAMA

**MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**

BELENDA BALLUKU

ANEKS

AGREGIMI I GRUPIT TË BALANCIMIT

I nënshkruari, në emër të palëve përgjegjëse balancuese, në vijim:

- Pala përgjegjëse balancuese : “ _____ ” _____, shoqëri aksioner _____, regjistruar në Rregjistrin Tregtar të mbajtur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS _____, me seli _____, _____, përfaqësuar nga Administratori _____.

Administrator

Në cilësinë e liderit të Grupit të Balancimit të _____, në përputhje me parashikimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr _____, datë _____.2021, ju informon se pjesë përbërëse e këtij grupi janë këto palë përgjegjëse balancuese:

- Pala përgjegjëse balancuese : “ _____ ” _____, shoqëri aksioner _____, regjistruar në Rregjistrin Tregtar të mbajtur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS _____, me seli _____, _____, përfaqësuar nga Administratori _____.

.....

Ky grup balancimi, vepron kështu si palë e vetme përgjegjëse balancuese për qëllim të programimit/ skedulimit dhe shlyerjes së detyrimeve financiare.

Në rast se një palë përgjegjëse balancuese dështon në dërgimin e programit/ skedulit të prodhimit të energjisë elektrike, atëherë parashikimi i programimit për këtë palë përgjegjëse balancuese do të bëhet nga lideri i grupit të balancimit.

Pala përgjegjëse balancuese: “ _____ ” _____, shoqëri aksioner _____, regjistruar në Rregjistrin Tregtar të mbajtur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS _____, me seli _____, _____, përfaqësuar nga Administratori _____.

Administrator

Ky konfirmim nënshkruhet në datë _____._____. 2021_____ nga OST SH.A.

Në emër të OST SH.A. konfirmuar nga _____ (Emri dhe pozicioni)

NR.PROT. 2677/1
DATË 10.6 - 2022

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË
OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT, SH.A
OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES, SH.A
OPERATORIT TË ENERGJISË SË RINOVUESHME, SH.A
ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

